



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА,
ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ - СКОПЈЕ
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE E
DEMOGRAFISË DHE E TË RINJVE - SHKUP

Бр. / Nr. 08-5725/1
01-08-2025 20 год. / viti

Procedura e përcaktimit të procedurës dhe të vendosjes së kriterëve për ndarjen e mjeteve për mbështetjen e projekteve të fushës së të rinjve

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë procedurë, përcaktohen subjektet, të cilave mund t'u ndahen mjete për mbështetje të projekteve të fushës së rinisë, si dhe procedura dhe kriteret për ndarjen e mjeteve, të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare të të Rinjve, si përcaktim dhe vizion strategjik i Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve (në tekstin e mëtejme: Ministria).

Neni 2

(1) Mjetet e Nenit 1, të kësaj Procedure janë mjete që Ministria i ndan gjatë një viti, dhe të njëjtat përcaktohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Programit 11, Ndarja 15001.

(2) Shuma e mjeteve të paragrafit (1) të këtij neni, përcaktohet për çdo vit veçmas në fillim të vitit aktual, me akte të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

SUBJEKTET, PËRFITUES TË MJETEVE

Neni 3

Subjektet të cilave u ndahen mjetet e nenit 2 të kësaj procedure janë shoqata të cilat:

- janë të regjistruara sipas Ligjit të Shoqatave dhe të Fondacioneve,
- janë të regjistruara në regjistrin e organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe organizatave ombrellë rinore,
- punojnë jo më pak se një vit nga data e regjistrimit të tyre në Regjistrin e Personave të Tjerë Juridikë në kuadër të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, para datës së publikimit të thirrjes,
- në raportin e fundit narrativ dhe financiar, kanë zbatuar të paktën dy aktivitete me ose për të rinjtë,



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

- punojnë me të rinjtë, aktivitetet e të cilëve u referohen të rinjve dhe kanë përvojë në realizimin e programeve ose të aktiviteteve me të rinjtë në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar,
- zbatojnë aktivitete që i referohen zhvillimit të statusit të të rinjve në shoqëri, ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve të të rinjve, edukimin, avancimin e statusit të grupeve të marginalizuara të të rinjve, inkurajimin e të menduarit kritik te të rinjtë, inkurajimin e aktiviteteve shkencore dhe kërkimore te të rinjtë, si dhe punën e të rinjve, pjesëmarrjen e të rinjve dhe
- nuk kryejnë aktivitete që përmbajnë elemente të gjuhës së urrejtjes, nxisin dhunë, intolerancë ndëretnike ose veprojnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe normat ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

SUBJEKTET – TRUPAT PUNUES QË VENDOSIN PËR NDARJEN E MJETEVE

Neni 4

- (1) Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve (në tekstin e mëtejme: Ministri) formon Komision, i cili i shqyrton kërkesat e pranura për dhënien e mjeteve pas thirrjes së publikuar nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Procedure.
- (2) Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, katër anëtarë të Ministrisë dhe një anëtar i jashtëm i Departamentit të Bashkëpunimit me Sektorin Joqeveritar të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (3) Komisioni, çdo kërkesë të parashtruar – projekt e shqyrton dhe e vlerëson veçmas.
- (4) Aplikimet e paplota dhe projektet e dorëzuara pas përfundimit të thirrjes publike, automatikisht përjashtohen nga shqyrtimi.
- (5) Dokumentet e nevojshme për aplikim të plotë janë: fletëparaqitja për mbështetje financiare, propozim-projekti, statuti dhe vendimi për regjistrimin e shoqatës ose të fondacionit, raporti narrativ për vitin e kaluar, si dhe llogaria përfundimtare e shoqatës ose e fondacionit për vitin e kaluar.



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

(6) Puna e Komisionit është publike dhe dokumentet, të cilat Komisioni i krijon gjatë procedurës së ndarjes së mjeteve, publikohen në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 5

(1) Komisioni i shqyrton dhe i vlerëson kërkesat e parashtruara, në përputhje me kriteret e përcaktuara të nenit 18 të kësaj Procedure, me zbatimin e dispozitave të neneve 3, 10 dhe 17 të kësaj Procedure. Tutje, kërkesat e pranuar radhiten sipas pikëve. Çdo anëtar i komisionit e vlerëson individualisht çdo kërkesë, me shënimin e pikëve në një tabelë për secilin prej kriterëve, si në vijim:

- 0 (zero) pikë nëse kriteri nuk plotësohet,
- 3 (tre) pikë nëse plotësohet pjesërisht,
- 5 (pesë) pikë nëse kriteri i kërkuar plotësohet plotësisht.

Pikët totale paraqiten përmes tabelës përmbledhëse, pas së cilës secila prej kërkesave diskutohet veçmas me arsyetimin e nevojshëm mbi kërkesat, për të cilat ka dallime më të mëdha në pikëzim.

(2) Për çdo kërkesë të shqyrtuar, Komisioni përgatit procesverbal të veçantë me Propozimin për Miratimin e Mjeteve, i cili nuk tejkalon 70 për qind të propozim-buxhetit të projektit, por jo më shumë se 300.000 denarë, dhe ia dorëzon Ministrit.

(3) Pas vlerësimit të propozim-projekteve, Komisioni përgatit një raport që i përmban elementët e mëposhtëm:

- Datën dhe vendin ku është kryer renditja dhe vlerësimi i kërkesave të parashtruara,
- Datën e pranimi të kërkesave,
- Subjektet – përfituesit, të cilët e kanë parashtruar kërkesën,
- Përbërjen e Komisionit, i cili e ka kryer renditjen dhe vlerësimin e kërkesave të pranuar,
- Mendimin dhe arsyetimin nëse duhet të ndahen mjete sipas kërkesës së parashtruar për ndarjen e mjeteve, përkatësisht nëse projektet e propozuara i plotësojnë kushtet për t'u ndarë fonde, nga kërkesat e pranuar,



- Сектор млади –
- Сектори i të Rinjve -

- Listën e pikëve për analizën e përmbushjes së kriterëve të parashikuara në këtë Procedurë, të cilën e plotëson secili anëtar i Komisionit të nenit 4 paragrafi (1) të kësaj Procedure,
- Listën përmbledhëse të pikëve, në të cilën paraqiten rezultatet e listave individuale të pikëve për analizën e përmbushjes së kriterëve të parashikuara në këtë Procedurë, e cila plotësohet nga Komisioni i nenit 4, paragrafi (1) të kësaj Procedure dhe
- Procesverbalet e veçanta të projekteve të vlerësuara.

Neni 6

(1) Në fazën e shqyrtimit dhe të vlerësimit të projekteve të propozuara nga shoqatat, Komisioni i nenit 4, paragrafi (1) të kësaj Procedure, së pari e vlerëson përshtatshmërinë e projekteve të propozuara, për zbatimin e të cilave do të ndahen mjete.

(2) Si projekt i përshtatshëm, i parashtruar pas thirrjes së publikuar, për zbatimin e të cilës do të ndahen mjete, konsiderohet të jetë:

- Propozim-projekti i kompletuar, i cili i përmban të gjitha informacionet e kërkuara, përfshirë edhe shtojcat e nevojshme,
- Propozim-projekti, korniza kohore për realizim e të cilit është nga një deri në 12 muaj dhe
- Projektet që janë në përputhje me prioritetet specifike vjetore të përcaktuara nga Strategjia Kombëtare e të Rinjve, përkatësisht nga Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë, e që janë të theksuara në Thirrjen për Pjesëmarrje mbi ndarjen e mjeteve për realizimin e projekteve në fushën e të rinjve me interes për Republikën e Maqedonisë së Veriut, programin vjetor të ministrisë dhe dokumenteve të tjera strategjike të ministrisë që ndërlidhen me të rinjtë.

Neni 7

Pas Raportit të parashtruar të nenit 5, paragrafi (3) të Propozimit për Miratimin e Mjeteve nga Komisioni, Ministri miraton një vendim për ndarjen e mjeteve, i cili publikohet në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 8



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

(1) Pas publikimit të vendimit për dhënien e mjeteve, nënshkruhen kontrata për realizimin e projekteve përkatëse me të gjitha shoqatat, projektet e propozuara të të cilave i plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë Procedurë.

(2) Kontrata e paragrafit (1) të këtij neni duhet t'i përmbajë, në veçanti, dispozitat e mëposhtme:

- Lëndën e kontratës,
- Shumën e mjeteve të ndara dhe orarin e financimit,
- Kornizën kohore për zbatimin e kontratës,
- Mundësinë e ndryshimit të dispozitave të kontratës në rast të rrethanave të ndryshuara në zbatimin e kontratës,
- Përgjegjësinë në rast të dëmit të shkaktuar,
- Detyrimin për t'i përdorur mjetet e ndara me ndërgjegje dhe përgjegjësi, si dhe për t'i kthyer mjetet e papërdorura,
- Metodën e raportimit, të vlerësimit dhe të monitorimit,
- Dispozitat për ushtrimin e kontrollit mbi zbatimin e kontratës dhe të shpenzimit të mjeteve të ndara,
- Dispozitat për zbatimin plotësues të ligjeve dhe të rregulloreve të tjera dhe
- Dispozitat e tjera në përputhje me ligjet dhe me aktet nënligjore.

Neni 9

(1) Subjektet e nenit 3 të kësaj Procedure parashtrojnë një raport përfundimtar mbi zbatimin e projektit përkatës, për realizimin e të cilit u janë ndarë mjete prej Ministrisë, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të realizimit të aktivitetit të fundit të të njëjtit.

(2) Raporti i paragrafit (1) të këtij neni duhet t'i përmbajë, në veçanti, elementët e mëposhtëm:

- Qëllimin për të cilin janë shpenzuar mjetet e ndara,
- Metodën e zbatimit të aktiviteteve përkatëse të ndërlidhura me pjesët e projektit të nenit 3 të kësaj Procedure (raporti narrativ),
- Datën dhe vendin ku janë shpenzuar mjetet për realizimin e projektit përkatës (fatura e bashkëngjitur, fletë-dorëzimi, certifikatat e llogarisë, kartat e kontabilitetit dhe dokumente të tjera për provë), - raportin financiar,
- Aktivitetet ose pjesët e mbuluara nga mjetet e ndara dhe ndërlidhja e tyre me listat e të pranishmëve, provat video dhe audio të aktiviteteve të zbatuara dhe



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

- Rezultatet dhe produktet e projektit të realizuar.

PROCEDURAT PËR NDARJEN E MJETEVE

Neni 10

- Mjetet e Nenit 2 të kësaj Procedure ndahen sipas procedurave të mëposhtme për ndarjen e fondeve:
- Procedurës së rregullt për ndarjen e mjeteve me publikim të thirrjes dhe
- Procedurës së jashtëzakonshme për ndarjen e mjeteve me publikim të thirrjes.

- (1) Procedura e rregullt për ndarjen e mjeteve me publikim të thirrjes

Neni 11

Procedura për ndarjen e mjeteve me publikim të thirrjes zbatohet në fazat e mëposhtme:

- 1) Publikimi i thirrjes për ndarjen e mjeteve,
- 2) Mbledhja e kërkesave për ndarje të mjeteve me propozim-projektet,
- 3) Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave të parashtruara për ndarje të mjeteve me propozim-projektet, nga komisioni përmes organit të administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e të rinjve,
- 4) Miratimi e vendimit për ndarjen e mjeteve,
- 5) Nënshkrimi i Kontratës për realizimin e projektit me shoqatën përkatëse të qytetarëve,
- 6) Monitorimi dhe vlerësimi i projektit të realizuar dhe renditja e organizatës dhe
- 7) Raporti mbi projektet e realizuara nga thirrja e shpallur.

Neni 12

(1) Në tremujorin e fundit të vitit aktual, Ministria shpall Thirrje për ndarje të mjeteve për mbështetje të projekteve nga fusha e të rinjve.

(2) Thirrja e paragrafit (1) të këtij neni, publikohet në të paktën dy media të shtypura dhe në ueb-faqen e Ministrisë, dhe zgjat të paktën 30 ditë nga data e publikimit.



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

(3) Në Thirrjen e paragrafit (1) të këtij neni, veçanërisht specifikohen kriteret që duhet t'i plotësojnë propozim-projektet, afati brenda të cilit ato duhet të parashtrohen, si dhe mënyrën e dorëzimit të kërkesës për ndarje të mjeteve me propozimet-projektet dhe personat kontaktues nga Ministria.

(2) Procedura e jashtëzakonshme për ndarjen e mjeteve me publikim të thirrjes

Neni 13

(1) Ndarja e jashtëzakonshme e mjeteve kryhet përmes arsyetimit të shkaqeve për ndarjen e jashtëzakonshme, përkatësisht të njëjtat mund të jenë mjete të rialokuara në buxhetin vjetor për shkak të kursimeve, urgjencës finale, ngjarjeve të paparashikuara shoqërore të ndërlidhura ngushtë me të rinjtë, të cilat janë pozitive dhe promovuese për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Procedura për ndarjen e jashtëzakonshme të mjeteve me publikim të thirrjes zbatohet në fazat e mëposhtme:

- 1) Publikimi i thirrjes për ndarjen e mjeteve,
- 2) Mbledhja e kërkesave për ndarjen e mjeteve me propozim-projektet
- 3) Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave të parashtuara për ndarjen e mjeteve me propozim-projektet, nga komisioni, përmes organit të administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e të rinjve,
- 4) Miratimi i vendimit për ndarjen e mjeteve,
- 5) Nënshkrimi i kontratës për realizimin e projektit me shoqatën përkatëse të qytetarëve,
- 6) Monitorimi dhe vlerësimi i projektit të realizuar dhe renditja e organizatës dhe
- 7) Raporti mbi projektet e realizuara nga thirrja e shpallur.

Neni 14

(1) Thirrja e nenit 13 të këtij neni, publikohet në ueb-faqen e Ministrisë dhe zgjat dhe do të zgjasë 3 ditë pune nga dita e shpalljes..

(2) Në thirrjen e paragrafit (1) të këtij neni, veçanërisht specifikohen kriteret që duhet t'i plotësojnë propozim-projektet, afati brenda të cilit ato duhet të parashtrohen, si dhe mënyra e dorëzimit të kërkesës për ndarjen e mjeteve me propozim-projektet dhe personat kontaktues nga Ministria.



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

KRITERET E NDARJES SË MJETEVE

Neni 15

Kriteret që duhet të përmbushen nga subjektet që i parashtrojnë propozim-projektet për ndarjen e mjeteve u referohen:

- Kritereteve të përgjithshme mbi përzgjedhjen e subjekteve/organizatave kandidate dhe
- Kritereteve specifike që ndërlidhen me Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të të Rinjve, programin vjetor të të rinjve dhe dokumentet strategjike që ndërlidhen me të rinjtë.

Kriteret e përgjithshme mbi përzgjedhjen e subjekteve

Neni 16

Kriteret mbi përzgjedhjen e subjekteve, të cilat i paraqesin propozim-projektet për ndarjen e mjeteve i referohen:

- Kapacitetit organizativ dhe
- Vlerësimit të propozim-projektit.

Neni 17

Kriteret që ndërlidhen me kapacitetet organizative janë:
Propozim-projekti të jetë në përputhje me misionin dhe objektivat e subjektit

- propozuesit,
- Subjekti - propozuesi të ketë përvojë të përshtatshme prej të paktën një viti në zbatimin e projekteve ose aktiviteteve të ngjashme,
- Subjekti - propozuesi duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale) drejt zbatimit të aktiviteteve të propozuara,
- Subjekti-propozues të përfshijë vullnetarë në punën e tij gjatë realizimit të propozim-projektit dhe
- Subjekti propozues të ketë program vjetor pune, strategji të organizimit ose plan veprimi.



- Сектор млади –
- Сектори i të Rinjve -

Neni 18

(1) Kriteret që ndërlidhen me vlerësimin e propozim-projektit janë:

1. Rëndësia e propozim-projektit,
2. Efektiviteti dhe efikasiteti i aktiviteteve të projektit,
3. Pjesëmarrja e grupeve të synuara,
4. Qëndrueshmëria e propozim-projektit,
5. Rezultatet e pritshme të matshme të propozim-projektit,
6. Efikasiteti buxhetor i propozim-projektit,
7. Produktet e aktiviteteve projektuese dhe
8. Dukshmëria e propozim-projektit.

Rëndësia e propozim-projektit vlerësohet sipas mënyrës në vijim:

- Propozim-projekti të bazohet në qëllimet dhe aktivitetet e përcaktuara nga Plan i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të të Rinjve, programi vjetor i të rinjve dhe dokumentet strategjike që ndërlidhen me të rinjtë,
- Problemi i zhvilluar të jetë një problem shoqëror aktual,
- Problemi që i zhvilluar të përfshijë një grup të rinjsh,
- Metodologjia e propozuar të jetë e përshtatshme për zgjidhjen ose të kontribuojë në zgjidhjen e problemit,
- Metodologjia e propozuar të gjenerojë mekanizma të vetëmjaftueshëm për të kontribuar në zgjidhjen e problemit dhe
- Rezultatet dhe treguesit e pritur të jenë të matshëm dhe në përputhje me rezultatet dhe treguesit e pritur të specifikuar të Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të të Rinjve, programit vjetor të të rinjve dhe dokumenteve strategjike që ndërlidhen me rininë.

(3) Efektiviteti dhe efikasiteti i propozim-projektit pasqyrohet në veçanti si në vijim:

- Aktivitetet e propozuara projektuese dhe rezultatet e pritura të çojnë drejt arritjes së objektivave specifike të projektit dhe
- Rezultatet e pritura të korrespondojnë me kostot e shkaktuara (raporti ndërmjet mjeteve të shpenzuara dhe rezultateve të fituara duhet të jetë proporcional).



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

(4) Pjesëmarrja e grupeve të synuara në propozim-projektin pasqyrohet në veçanti si në vijim:

- Projekti i propozuar të bazohet në aktivitetet që i përfshijnë drejtpërdrejt palët përkatëse (të rinjtë, shoqatat e tjera, qeverinë lokale ose qendrore, institucionet e tjera).

(5) Qëndrueshmëria e propozim-projektit pasqyrohet në veçanti si në vijim:

- Projekti të krijojë mekanizma për ruajtjen e rezultateve edhe pas përfundimit të financimit.

(6) Rezultatet e pritura të propozim-projektit pasqyrohen në veçanti si në vijim:

- Projekti i propozuar të gjenerojë rezultate konkrete dhe të matshme afatshkurtra,
- Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit,
- Qasja e propozuar të sigurojë përfshirje të barabartë të burrave dhe të grave dhe
- Qasja e propozuar të sigurojë përfshirje të barabartë të të rinjve nga komunitete të ndryshme etnike.

(7) Efikasiteti i buxhetit të propozim-projektit pasqyrohet në veçanti si në vijim:

- Nëse (në çfarë mase) buxheti i propozuar korrespondon me kostot aktuale të ndërlidhura me projektin.

**Kriteret specifike që ndërlidhen me Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë
Kombëtare të të Rinjve**

Neni 19

(1) Propozim-projektet duhet të orientohen drejt zbatimit të disa prej aktiviteteve specifike të Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të të Rinjve, programit vjetor të të rinjve dhe dokumenteve strategjike që ndërlidhen me të rinjtë.

(2) Për miratimin e mjeteve, është e nevojshme që propozim-projektet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme të kësaj Rregulloreje.



- Сектор млади -
- Сектори i të Rinjve -

Ndarja e çmimeve për projektet e zbatuara përmes Ministrisë

Neni 20

(1) Për projektet e realizuara nga Ministria nëpërmjet Sektorit të të Rinjve, çmimet u ndahen pjesëmarrësve më mirë të renditur në projektin konkret.

(2) Ministri merr vendim mbi ndarjen e çmimeve pas aktit përkatës të marrë paraprakisht nga një komision ekspertësh.

(3) Сектори i të Rinjve në Ministri e zbaton vendimin e përmendur në paragrafin (2) të këtij neni.

PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Neni 21

Parandalimi i konfliktit të interesave kryhet nëpërmjet deklaratës për (mos)ndërlidhjen me organet dhe zyrtarët vendimmarrës, të cilën, çdo subjekt/propozues i projektin, detyrimisht e dorëzon me propozim-projektin, e që është në përputhje me ligjin përkatës, i cili e rregullon materien konkrete. Deklarata paraqet një formular të përcaktuar që është pjesë përbërëse e kësaj Procedure.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Интерпретими i dispozитave të kësaj Procedure jepet nga Ministria.

Neni 23

Kjo Procedurë hyn në fuqi ditën e miratimit të saj.

Ministri,
Fatmir Limani



Изработил/Пërpiloi: Елеонора Јовановиќ/советник/Кëshilltare

Превод/Пërkthimi: Kefsere Ljoki

Контролирал/Контролои: Арта Сulejmani, раководител на одделение/udhëheqëse Njësie

Одобрил/Miratoi:

Согласен/Пајтоhet: Fatmir Sabriu, државен секретар/Sekretar Shtetëror



- Сектор млади -
- Sektori i të Rinjve -

DEKLARATË se nuk ka konflikt interesi

Unë _____, në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës _____ nën përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale, DEKLAROJ se lidhur me kërkesën/projektin e parashtruar për ndarjen e mjeteve për _____ në përputhje me Procedurën e rregullt/të jashtëzakonshme të publikuar më dt. _____, nuk jam në gjendje konflikti interesi dhe nuk kam asnjë interes privat mbi ndarjen e mjeteve për zbatimin e tyre ose çfarëdo përfitimi tjetër material ose jomaterial për veten time ose për të afërmit e mi të ngushtë, si rezultat i pjesëmarrjes sime në procedurë.

Shkup, _____ Dt.
(vendi dhe data)

Deklaroi,
